



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr.2221 Prot  
Nr.1648/1 Dosje



Tiranë, më 07.12.2018

**V E N D I M**  
**PËR PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT**

Unë, Florian Shehu, me detyrën e Përmbarduesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbardimit “TDR Group” sh.p.k., në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.7438 Akti, të lëshuar me datë 16.12.2011 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vënë në ekzekutim ky Urdhër, duke u regjistruar në dosjen përmbardimore Nr.1648/1, Datë 20.03.2018 kërkesa e **Kreditorit Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Sherbimeve Shoqërore, Dega Rajonale Tirane** ndaj debitorit “Artur Barameta”, person fizik me Nr. NIPT K83219803N, dhe Z.Artur Barameta (ne cilesine e administratorit) ne lidhje me “Vendim gjobe Nr. 0210, datë 30.11.2010”.

Pasi eshte filluar procesi i ekzekutimit te detyrueshem nga Sherbimi Permbarimor “ZIG” sh.p.k , duke i dërguar debitorit Njoftimin Nr. 540 Prot, Datë 21.03.2018, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr.7438 Akti, të lëshuar me datë 16.12.2011 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile. Vazhdimi i procedures permbarimore ka vazhduar prane shoqerise TDR Group pasi subjekti i meparshem permbarimor e mbylli aktivitetin.

Urdherat per vendosjen e sekuestrove konservative jane derguar ne :

- a) 16 – Bankat Tregetare , me shkresen Nr. 1857 Prot. Date 12.10.2018
- b) QKB-Tirane me shkresen Nr. 38512 Regj.-Nr.09061 Prot. Date 19.04.2012

Lidhur sa me siper, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale te nevojshme per ekzekutimin e plote te titullit ekzekutiv me palet e lartpermendura,





## KONSTATOJ

Se debitori e ka shlyer te gjithë shumen e detyrimit ne llogarine bankare prane Bankes ABI te shoqerise permbarimore "TDR Group" e vertetuar edhe nga mandat pagesa perkatese.

Ne keto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) te Kodit te Procedures Civile dhe nenit 32. Pikat (b,c) te Ligjit Nr. 10031, date 11.12.2008 "Per Sherbimin Permbarimor Gjyqesor Privat",

## VENDOSA

1. Pushimin e ekzekutimit të Urdhërit të Ekzekutimit **Nr.7438 Akti, të lëshuar me datë 16.12.2011 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, pasi detyrimi është shlyer tërësisht.
2. Bankat e Nivelit II të bëjnë zhblokimin e depozitave, kredive apo llogarive bankare të **Subjekti "Artur Barameta", person fizik me Nr. NIPT K83219803N dhe Z. Artur Bujar Barameta i datelindjes 14.04.1978 (Ne cilesine e administratorit)**, të bllokuara me shkresen Nr. 1857 Prot. Date 12.10.2018 të Shoqërisë Përmbareme "TDR Group".
3. DRSHTRR-Durres te bej zhblokimin e dokumentacionit te automjeteve te **Subjekti "Artur Barameta", person fizik me Nr. NIPT K83219803N dhe Z. Artur Bujar Barameta i datelindjes 14.04.1978 (Ne cilesine e administratorit)**, (Ne cilesine e administratorit), te cilat mund te jene bllokuar me shkresen Nr. 38512 Regj.-Nr.09061 Prot. Date 19.04.2012 të Shoqërisë Përmbareme "ZIG" sh.p.k, procedure e cila ka konkluduar prane shoqerise TDR pas transferimit te dokumentacionit te dosjes permbarimore.
4. Qendren Kombetare te Biznesit - QKB te bej zhblokimin e te gjitha aksioneve te **Subjekti "Artur Barameta", person fizik me Nr. NIPT K83219803N dhe Z. Artur Bujar Barameta i datelindjes 14.04.1978 (Ne cilesine e administratorit)**, (Ne cilesine e administratorit), te cilat jane bllokuar me shkresen Nr. 38512 Regj.-Nr.09061 Prot. Date 19.04.2012 të Shoqërisë Përmbareme "ZIG" sh.p.k, procedure e cila ka konkluduar prane shoqerise TDR pas transferimit te dokumentacionit te dosjes permbarimore.

Ky vendim mund të ankimohet përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 5-ditësh.

**SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT "TDR GROUP" sh.p.k**

**PËRMBARUES GJYQËSOR**

**FLORIAN SHEHU**



Shoqëria Përmbareme Gjyqësore Private "TDR Group" Sh.p.k  
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr. 5, Kati i 11-të, Nr. 54, Tiranë  
Tel: 00355 42 427790  
www.tdr.al